

VENDIM
Nr. 39, datë 29.3.2024

**MBI ECURINË E ZBATIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË TË ERE-s PËR
PERIUdhËN 2021–2023, SIPAS PLANIT TË MASAVE PËR ZBATIMIN E
OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË PËR PERIUdhËN 2021–2023, TË PËRDITËSUAR**

Në mbështetje të neneve 10, 16, 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.3.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 829 prot., datë 27.3.2024, “Mbi ecurinë e zbatimit të objektivave strategjike të ERE-s për periudhën 2021–2023”,

konstatoi se:

- Në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, në nenin 4 parashikohet se ministria përgjegjëse për energjinë harton Strategjinë Kombëtare të Energjisë, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe përditësohet të paktën çdo pesë vjet. Strategjia Kombëtare e Energjisë përcakton objektivat e zhvillimit të sektorit të energjisë, si dhe rrugët e arritjes së tyre, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të ekonomisë kombëtare për një periudhë afatmesme dhe afatgjatë, harton programet afatmesme për zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë.

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 74, datë 12.3.2021, miratoi objektivat strategjike të ERE-s për vitet 2021–2023 dhe në vijim është miratuar Kalendari i Përditësuar i Masave të ERE-s, për zbatimin e këtyre objektivave strategjike. Pas analizimit dhe vlerësimit të ecurisë së zbatimit të objektivave strategjike për vitet 2021–2023, çdo vit, ERE ka miratuar planin e veprimit, të përditësuar, me qëllim arritjen e objektivave të vendosura për periudhën 2021–2023.

- Plani strategjik trevjeçar në fokus kishte:” Incentivimin e teknologjisë së lëvizjes së makinave elektrike, sensibilizimin e konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike, mbrojtjen e konsumatorëve përmes ndërgjegjësimit, përcaktimin e treguesve të matjes dhe vlerësimit të performancës së shërbimit ndaj klientit që garanton çdo i licencuar në furnizim, monitorimin e furnizuesve në treg të lirë lidhur me zbatimin e rregullores, sensibilizimin e konsumatorëve mbi racionalizimin e energjisë elektrike, dhënien zë të konsumatorëve, mbrojtjen e klientëve në nevojë, zhvillimin e një portali për konsumatorët.

- Vlerësohet se ERE ka përmbushur detyrat e përcaktuara në objektivat strategjike të parashikuara për periudhën 2021–2023.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit të realizimit të objektivave strategjike të ERE-s, për periudhën 2021–2023.

2. Gjetjet e këtij raportimi do të jenë pjesë e Raportit Vjetor të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË
Erjola Sadushi